



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:206353  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05637066

KPPP.nr.1560/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Ndërmarrja Shoqërore “NewCo Grand Hotel” (në likuidim), me NRB: 810518425, kundër debitorit FBK “Federata e Basketbollit të Kosovës”, me seli në Prishtinë, lagjja “Arbëria”, Rr. “Radovan Zogoviq”, C3/faz.2, me nr.fiskal: 600206983, duke vendosur lidhur me propësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.680/23 të datës 04.09.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Irfan Kërçagu me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës me datë 23.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar propësimi i debitorit FBK “Federata e Basketbollit të Kosovës”, i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.680/23 të datës 04.09.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Irfan Kërçagu, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, me Urdhrin Përmbartimor P.nr.680/23 të datës 04.09.2023, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme–faturave dhe atë: faturës nr.254/21 të datës 30.08.2021, faturës nr.255/21 të datës 06.09.2021, faturës nr.256/21 të datës 06.09.2021, faturës nr.257/21 të datës 06.09.2021, faturës nr.258/21 të datës 06.09.2021, faturës nr.259/21 të datës 06.09.2021, faturës nr.260/21 të datës 06.09.2021, faturës nr.261/21 të datës

06.09.2021, faturës nr.262/21 të datës 06.09.2021, faturës nr.263/21 të datës 06.09.2021, dhe faturës nr.264/21 të datës 06.09.2021, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në emër të përmbushjes së faturave për shërbimet e pranuar, t'ia paguajë kreditorit shumën prej 12,092.00 Euro, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës së përmbarrimit dhe procedurës gjyqësore, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër urdhrimit të Përmbarruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, për shkak se urdhri përmbarrimor është i papranueshëm, rrjedhimisht është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe LMD-së, me arsyetimin se debitori në asnjë rast nuk ka mohuar pagesën e faturave të sakta për shërbimet e ofruara nga kreditori gjatë tërë marrëdhënies kontraktuale mes palëve gjë që vërtetohet me tri pagesa të kryera në dobi të tij gjatë tri viteve të fundit. Më tej ka theksuar se ka pasur përpjekje për të arritur deri tek përmbushja e obligimeve të akumuluar nga ana e debitorit dhe është dhënë sqarim për mungesën e mjeteve të nevojshme financiare, mungesë e cila është dashur të mirëkuptohet. I ka kërkuar gjykatës që të anulohet përmbarrimi i iniciuar në bazë të propozimit për përmbarrim, të anulohen gjitha veprimet përmbarrimore të ndërmarra në këtë procedurë, si dhe të udhëzojë palët që të arrijnë marrëveshje të përmbarrueshme për detyrimin përfundimtar të konfirmuar mes tyre.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të paargumentuar me asnjë provë në kuptim të nenit 69 të LPP-së i cili përcakton se *“Baza për prapësim duhet të mbështetet në prova të duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*. Debitori ka theksuar se për këto arsye, prapësimi duhet të hedhet poshtë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarrim dokumentet e besueshme faturën nr.254/21 të datës 30.08.2021, faturën nr.255/21 të datës 06.09.2021, faturën nr.256/21 të datës 06.09.2021, faturën nr.257/21 të datës 06.09.2021, faturën nr.258/21 të datës 06.09.2021, faturën nr.259/21 të datës 06.09.2021, faturën nr.260/21 të datës 06.09.2021, faturën nr.261/21 të datës 06.09.2021, faturën nr.262/21 të datës 06.09.2021, faturën nr.263/21 të datës 06.09.2021, dhe faturën nr.264/21 të datës 06.09.2021, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbarrimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit monetar, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarrimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1560/23, me datë 23.04.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.